



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:279148

Datë: 10.03.2021

Numri i dokumentit: 01583847

AA.nr.62/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “K...” sh.p.k, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1298/2017, të datës 10.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.03.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “K...” sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1298/2017, i datës 10.11.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1298/2017, të datës 10.11.2020, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “K...” sh.p.k, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit PSH.nr.312/17, i datës 06.07.2017, i protokolluar me nr.521/17 i datës 11.07.2017.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat N.P., nga Prishtina, për shkak të: shkeljes së dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrativ, dhe shkeljes së dispozitave materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të anulohet vendimi i të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit PSH.nr.312/17, i datës 06.07.2017, ose çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet

Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Organit Shqyrtues të Prokurimit PSH.nr.312/17, të datës 06.07.2017, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e Konzorciumit: “C....” sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i grupe matëse në kufirin në mes K..../K./OSSH”, me nr.prot. “14-12-84-511”, i iniciuar nga autoriteti kontraktues K.... SH.A. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, është vërtetuar vendimi i AK-së K.... SH.A, për dhënie të kontratës “Np M... dhe G3 Inxhinjering” – Prishtinë / Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i grupe matëse në kufirin në mes K..../K./OSSH”, me nr. prot. “14-12-84-511. Nën pikën III të dispozitivit të vendimit, zbatohet vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me numër A.nr.2253/2014 i datës 04.04.2017, që lidhur me këtë ankesë të vendoset me vendim e jo me konkluzion.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 02.08.2017, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se në këtë çështje të konfliktit administrativ drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Andaj, për këto arsye thënie e paditësit nuk i aprovoi, sepse të njëjtat i ka vlerësuar si të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar nenit 59 par. 4 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, me të cilin përcaktohet se “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”. Po ashtu,

gjykata e shkallës së parë e të drejtë iu ka referuar nenit 56 të të njëjtit Ligj, me të cilin përcaktohet se “1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes: 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 40 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. 2. Në rastin e procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do t’i zgjedhë kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar tender ose propozim, vetëm në bazë të: 2.1 kriterëve të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me paragrafin 2. të nenit 51 të këtij ligji dhe 2.2 dokumenteve, informatave dhe/ose dëshmimeve mbi kualifikimet e dorëzuara nga kandidatët si përgjigje të drejtpërdrejt ndaj kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet para kualifikuese. Kandidatët që nuk zgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme. Të gjithë kandidatët të cilët konstatohet se i plotësojnë kriteret e specifikuara dhe të cilët nuk janë përjashtuar sipas këtij paragrafi, do të ftohen që të dorëzojnë tender, përveç nëse numri i këtyre kandidatëve tejkalon numrin gjashtë (6). Nëse numri i kandidatëve tejkalon numrin gjashtë (6) atëherë autoriteti kontraktues do të ftojë vetëm gjashtë kandidatët më të kualifikuar që të dorëzojnë tender. KRPP në rregullat e prokurimit publik do të vendosë një procedurë detale që autoritetet kontraktuese duhet ta respektojnë gjatë përzgjedhjes në fjalë. KRPP do të sigurojë që procedura e tillë është: (i) në përputhshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare, (ii) siguron konkurrencë dhe transparencë adekuate, (iii) i zbaton parimin e mos-diskriminimit, dhe (iv) dhe përndryshe është në përputhshmëri me dispozitat aplikative të këtij ligji. 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka referuar edhe nenit 60 të të njëjtit Ligj, me të cilin përcaktohet se “1. Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji. 2. Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji”.

Po ashtu, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar ankesën e paditësit Operatorit Ekonomik Konsorciumit “C.....” sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i grupeve matëse në kufirin në mes K...../K../OSSH”, pasi që e paditura me rastin e vlerësimit të ankesës së Operatorit Ekonomik Konsorciumit “C.....” sh.p.k, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Kosovës. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësi, mirëpo të njëjtat me të drejtë i ka konsideruar si të pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike, kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, dhe atë nga vlerësimi i Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe raportit kronologjik të ekspertëve shqyrtues – teknik të datës 04.05.2017, është vlerësuar se të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit janë plotësuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera ankimore se arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar përmban përshkrimin identik të vendimit, anulimi i të cilit kërkohet. Pastaj se, gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit citon në tërësi dispozitat e LPP-së, për të cilat pretendohet se janë shkelur, dhe pastaj arsyetimin se gjoja këto dispozita nuk janë shkelur e merr nga vendimi i të paditurës në tërësi, por nuk jep ndonjë vlerësim dhe analizë vetanake për çështjen kyçe kontestuese se a i kishte përmbushur kushtet e tenderit operatori ekonomik i shpallur fitues në raport me specifikat teknike nga dosja e tenderit, ndërsa i vetmi përfundim i gjykatës është se paditësi pretendimet e tij nga padia dhe seanca nuk i ka provuar me asnjë provë. Po ashtu, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare, por bazohet kryesisht në arsyetimet e dhëna në vendimin kontestues, dhe se i njëjti nuk përmban as arsye për kuptimin e termit “Specifikimi teknik”, i përkufizuar me nenin 4 par.1 nën par.1.63 dhe 1.64 të LPP-së. Gjithashtu, nga provat në shkresat e lëndës pa mëdyshje vërtetohet fakti se OE i shpallur fitues nuk i kishte përmbushur kërkesat nga dosja e tenderit, andaj, edhe nuk mund të arsyetohej në asnjë mënyrë shkelja e dispozitave të LPP-së, ashtu siç ka bërë në vendimin kontestues e paditura. Pra, oferta e OE fitues nuk ishte në pajtim me specifikat teknike, dhe përbente shkelje të nenit 28 lidhur me nenin 59 dhe 60 të LPP-së, për çka vendimin e të paditurës e bënë të paligjshëm. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes kolegji i kësaj gjykate gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se Paneli Shqyrtues i Organit të paditur ka vepruar në mënyrë të drejtë, kur ka konstatuar se gjatë shqyrtimit / analizimit të procesit të zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, raportit të ekspertizave të ekspertëve dhe pretendimeve ankimore, si dhe duke u mbështetur në të gjitha provat dhe faktet relevante, ka ardhur në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 dhe 56 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë “Np M.... dhe G3 Inxhiniering”, me seli në Prishtinë, është i përgjegjshëm dhe i ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet e dosjes së tenderit, dhe njëherit është respektuar dispozita e nenit 60, ku në bazë të kësaj dispozite është një ndër kriteri kryesor për dhënien e kontratës, e që për faktin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratën e lartcekur ka ofruar çmimin më të lirë se Operatori Ekonomik ankues Konsorciumi C..... Andaj, pasi që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar çmimin më të ulët se sa konsorciumi ankues, autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka pasur parasysh Ligjin Nr.04/042 të Prokurimit Publik.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht i referohet edhe konstatimit të paditurës nga vendimi kontestues se gjoja paditësi nuk qenka palë me interes material në këtë çështje. Ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara, ngase gjykata e

shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në këtë aktivitet të prokurimit paditësi është palë pa interes juridik material konform nenit 4 par.1.26 të LPP-së, përkitazi me nenin 111 par.1.5 dhe 1.8, pasi që në asnjë mënyrë nuk ka mundur që të dëshmoj se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktoj dëm këtij operatori ekonomik. Pra, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.62/2021, me datë 04.03.2021

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi